



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

**DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E MINIERAVE
DHE INDUSTRIË**

Nr. 2638/1 prot.

Tiranë, më 04.03.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1330, datë 17.03.2009.

SHOQËRISË “FRENKI” SH.P.K
Fshati Linze, Qesarak, Njësia administrative Dajt, Qarku Tiranë.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “Frenki” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1330, datë 17.03.2009, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Krastë Makaresh”. Krujë.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.1668/1 datë 28.02.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.2603 datë 28.02.2019 dhe me shkresën nr. 1827, datë 01.03.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.2639 datë 01.03.2019, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1330, datë 17.03.2009, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Krastë Makaresh”, Krujë, për arsye se:

- Nuk është zhvilluar aktivitet minerar në zonën për të cilën është dhënë leja minerare në përputhje me projektin e miratuar për këtë objekt.
- Nuk ka realizuar për vitin 2018 prodhimin e programuar prej 1000 m³, pasi për vitin 2018 nuk ka raportuar prodhim dhe shitje minerali.

Shoqëria në zbatim të pikës 6 të nenit 24 të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të kishte aplikuar për zgjatjen e afatit 180 ditë përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë së lejes që është data 17.03.2019, të cilën nuk e ka bërë.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në germën “dh”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e**

procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1330, datë 17.03.2009, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Krastë Makaresh”, Krujë. që shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.1330, datë 17.03.2009, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Krastë Makaresh”, Krujë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

**MINISTRI
BELINDA BALLUKU**

**ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI**

ILIR BEJTJA

